

Tiranë, më 17/12/2021

## **BUXHETI I VITIT 2022**

### ***1- Objektivat e buxhetit 2022***

Krijimi i një sistemi për realizimin dhe evidentimin e të ardhurave në përgjithësi dhe të ardhurave nga kuotat mujore në veçanti, së pari nëpërmjet rritjes së bazës së atyre që do të paguajnë kuotat mujore, dhe së dyti nëpërmjet evidentimit , saktësimit të anëtarëve që ushtrojnë profesionin nëpërmjet mbikqyrjes profesionale dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera.

### ***2- Detajimi i buxhetit për vitin 2022***

Hartimi i Projektbuxhetit është mbështetur në realizimin faktik të vitit 2021, objektivat që Urdhri ka për vitin 2022, si për realizimin e të ardhurave ashtu dhe për përdorimin e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike.

Buxheti është i detajuar sipas natyrës ekonomike.

Buxheti parashikohet të jetë i balancuar.

#### **2.1 Planifikimi i të Ardhurave**






Planifikimi i të Ardhurave bazohet nga të dhënat që disponojmë si:

- Numëri i anëtarëve të Urdhrit të regjistruar në Regjistrin Kombëtarë në funksionin e Drejtuesit Teknik.

- Numri i anëtarëve të Urdhrit të regjistruar në Regjistrin Kombëtarë , në funksionin e Farmacistit të punësuar.
- Numëri i anëtarëve të Urdhrit të regjistruar në Regjistrin e Vecantë , të Ndihmës Farmacistëve.
- Numëri i antarësimeve të reja , referuar regjistrimeve të kandidatëve për provimin e Shtetit për dy sezonet Maj- Dhjetor 2021.
- Numëri i praktikantëve të regjistruar për praktikën profesionale viti 2021.
- Në realizimin e të ardhurave për periudhën e ushtrimore si dhe i pritshmi deri në fund të vitit 2021.


*Të dhënat për planifikimin e të Ardhurave për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 paraqiten si më poshtë:*

000/lekë

Nr	Emertimi	Plani 2021	Plani 2022	%
	<b>TE ARDHURA</b>			
1	Kuota antarësimi	<b>30,300</b>	<b>28.992</b>	<b>4.32%</b>
	- Drejtues Teknik	19.500	20.160	
	- Farmacist i punësuar	9.000	7.800	
	- Nd/farmacist	1,800	1,032	
2	Regjistrimet e reja	2.272	2.088	8.1% 
3	Praktika Profesionale	2.045	2.835	38.6% 
4	Të Tjera (riprintime)	680	940	38.2% 
5	Mbulimi me likujditetet	10,938	10.855	0.76% 
	<b>TOTALI</b>	<b>46.235</b>	<b>45.710</b>	

Referuar zerave të të Ardhurave, shikojmë se të ardhurat krahasuar me vitin 2021 kanë pësuar një rënie. Kjo rënie më e theksuar është në të ardhurat nga anëtarësimet e reja në masën 8.1%. Gjithashtu rënie ka në të ardhurat nga kuotat për anëtarët në funksionin e Drejtuesit Teknik për vitin 2022 kanë një rënie prej 4.32%. Një rritje e lehtë shihet në zërin e të ardhurave nga anëtarët në pozicionin e Drejtuesit Teknik.


**Ecuria e të ardhurave nga viti 2021 në vitin 2022 paraqitet grafikisht si më poshtë:**



- ✓ **Të Ardhura nga kuotat e anëtarëve që ushtrojnë funksionin e Drejtuesit Teknik**, janë bazuar në numërin e regjistrimeve të nxjerra nga zyra e regjistrimit dhe parashikimi deri në Dhjetor 2021, gjithësej 1,680 anëtarë.

- ✓ **Të Ardhura nga kuotat e antarëve Farmacist të punësuar**, janë bazuar në numërin e regjistrimeve të nxjerra nga zyra e regjistrimit dhe parashikimi deri në Dhjetor 2021, gjithësej 1,300 anëtarë.
  
- ✓ **Të Ardhura nga kuotat e Nd/farmacistëve** , janë bazuar në numërin e regjistrimeve të nxjerra nga zyra e regjistrimit deri në Dhjetor 2021,gjithësej 86 anëtarë.
  
- ✓ **Të Ardhurat nga Tarifat e Regjistrimeve të reja**, janë bazuar në numrin e studentëve të regjistruar për provimin e Shtetit Maj 2021 dhe Dhjetor 2021, gjithësej 185 kandidatë.
  
- ✓ **Të ardhura nga Praktika**, janë bazuar në numërin e praktikantëve të regjistruar gjatë vitit 2021 për të dy zezonet Korrik 2021 dhe Dhjetor 2021 , gjithësej 210 praktikantë . Në këtë grup të ardhurash janë përfshirë dhe të ardhurat nga tarifa e regjistrimit për praktikantët që regjistrohen si përsëritës të provimit të aftësimit praktik, gjithësej sipas të dhënave të zyrës së praktikës për vitin 2021 janë 147 praktikantë.

**Planifikimi i të Ardhurave sipas peshës specifike të tyre , paraqitet si vijon:**



Realizimi i të ardhura , që përbën bazën e realizimit të objektivave të Urdhrit kërkon punën e të gjithë organeve të Urdhrit si atyre të zgjedhur ,ashtu dhe atyre të emëruar.

## 2.2 SHPENZIMET

Shpenzimet janë planifikuar sipas strukturës ekonomike , dhe kanë për qëllim të mbështesin të gjithë aktivitetin e Urdhrit për vitin 2022 , me qëllim realizimin e misionit të Urdhrit, që do të përkthehet në rritjen e nivelit të Shërbimit Farmaceutik.

**Ndarja sipas strukturës ekonomike .**

- 1- **Shpenzimet e personelit**, të cilat janë përcaktuar sipas numërit të punonjësve të miratuar në Këshillin Kombëtar dhe pozicioneve të tyre në strukturë. Në këtë zë përfshihen pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore, shpërblimi ushqimorë sipas VKM nr.68 ,datë 07/02/2018, si dhe Fondi i Veçantë.
- 2- **Shpenzime Operative**, janë llogaritur për funksionimin normal të punës së administratës së Aparatit Qëndrorë dhe funksionimin e strukturave Rajonale. Në këtë strukturë përfshihen shpenzimet për kancelari, shtypshkrime, bojë për printerat, shpenzime për shërbime si energji elektrike , uje, telefon , mirëmbajtje automjetesh, siguracione, taksa vendore, shpenzime gjyqësore,auditime, shpenzime dieta, pritje percjellje, karburant etj.
- 3- **Shpenzime për Honorare**, janë shpenzimet për pagesat e honorarëve mujore të anëtareve të Këshilliave Rajonal dhe pagesat për ditëmbledhje të Këshillit Kombëtarë ,Këshillave Rajonal ,si dhe honorarët për antarët e komisioneve të përhershme dhe Ad-Hoc të ngritura pranë Urdhrit, referuar nivelit të honorarit të miratuar nga Këshilli Kombëtar.
- 4- **Shpenzime për Qira** , janë shpenzimet për mbulimin e pagesës së qirasë së objektit ,pronë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky zë shpenzimesh për vitin 2022 ka një rritje. Lidhja e kontratës së qirasë me Shoqërinë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”, e cila ka përthithur kompaninë Ish Tipografia Ushtarake, me të cilën Urdhri kishte kontratën e qirasë, është bërë referuar VKM 421 datë 12/06/2018 për një nryshim në VKM nr.54 date 05.02.2014, I cili ka ndryshuar kriteret e llogaritjes së detyrimit për m2,duke e rritur atë,

referuar dhe çmimeve referencë të zonës. Gjithashtu në llogaritjen e vlerës së kontratës është përfshirë dhe kostoja e ruajtja fizike të zyrave nga kompania “Illyrian Guard” dhe parkimi për makinat e urdhrit.

- 5- **Investime për pajisje Zyre**, janë shpenzime për blerje të pajisje për zyrat si ato kompjuterike , referuar kërkesave të bëra dhe nga Presidentët e Këshillave Rajonal
- 6- **Shpenzime për aktivitete të Edukimit në Vazhdim**, janë projektet që do të realizohen për aktivitete të Edukimit në Vazhdim në fushën Farmaceutike . Për Urdhrin është viti i shtatë që kreditet e përfituara nga aktivitetet e Edukimit në Vazhdim , i ofron falas për anëtarët e tij.Këto shpenzime mbulohen 100% nga buxheti i Urdhrit.
- 7- **Shpenzime për Botime Shkencore**, janë shpenzime të planifikuara për mbulimin e të gjitha zërave të shpenzimeve që nevojiten për botimet që urdhri ka në projektet e tij .
- 8- **Fondi Rezervë**, i cili është përcaktuar me vendim të Këshillit Kombëtarë , me qëllim blerjen e aseteve pronë të Urdhrit .

*Planifikimi i Shpenzimeve për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 paraqitet sipas tabelës:*


000/lekë

Nr	Emërtimi	Plani 2021	Plani 2022
	<b>SHPENZIMET GJITHSEJ</b>		
1	Paga dhe shpërblime	15,466	15,791
2	Fondi I Veçantë	922	922
3	Kontributet e sig. shoqerore e shendetsore	4,477	4,477
4	Honorare	9,600	9,300
	Shpenzime operative	8,000	6,000

6	Qira zyrash	770	2,220
7	Investime	1,000	1,000
8	Aktivitetet e Edukimit në vazhdim	5,000	5,000
9	Botime	1,000	1,000
	<b>TOTALI</b>	<b>46,235</b>	<b>45.710</b>

Siç shihet dhe nga tabela kemi ndryshime në dy zëra të Projekt Buxhetit. Kemi një ulje të shpenzimeve operative në masën 25%, dhe një rritje të zërit të shpenzimeve për qiranë.

***Dhe në mënyrë grafike niveli i shpenzimeve për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 paraqiten si vijon:***





Siç shihet dhe nga grafiku , zërat kryesorë të shpenzimeve i përkasin zerit të Edukimit në vazhdim dhe zërit të honorareve.Realizimi i zërave të shpenzimeve do të bëjë të mundur realizimin e projekteve që urdhri ka për vitin 2022.

**Niveli i shpenzimeve sipas peshës specifike të tyre në mënyrë grafike paraqiten si vijon:**



**Zbatimi i Buxhetit** ,do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

**Arkëtimet**, do të vazhdojnë të bëhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar , i vërtetuar me mandat arkëtimi të bankës.

**Shpenzimet** , do të bëhen sipas procedurave të përcaktuara dhe të mbështetura në dokumenta standarte të miratuara për Financat dhe për Kontabilitetin.

**Ndjekja dhe zbatimi i Buxhetit**, do të bëhet nga Aparati Qendrorë i Urdhrit.